




MINISTRIA FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE
DEGA E DOGANES KAPSHTICE



Nr. 1892 prot

Kapshticë, më 2 / 07 / 2025

Lënda: Dërgohet kërkesë për veprime

Drejtuar: **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**
DREJTORIA E KOORDINIMIT DHE MARRËDHËNIEVE ME JASHTË
TIRANE

Drejtuar: **DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË DOGANAVE**
DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETESE
TIRANE

Dega Doganore Kapshticë, e ushtron funksionin në mbështetje të Ligjit 102/2014 31/07/2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” dhe gjatë ushtrimit të funksionit, një ndër misionet e përcaktuara nga ligji, është edhe mbikqyrja e shkeljeve doganore dhe ndëshkimi i tyre.

Në ushtrim të funksionit Dega Doganore Kapshticë, ka ndëshkuar dhe shpallur debitor shoqerine e vendosur ne shtetin e Malit te Zi konkretisht “Lima Trade DOO” me vendimin Nr 5 datë 06/01/2025, vendim i mare ne mbeshtetje të Konstatimit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Në mbeshtetje të dispozitave Ligjit 102/2014 datë 31/07/2014 “Kodi Doganor i Republikës së shqipërisë”, neni 280 e vijues, për të vijuar procedurat për rikuperimin e borxhit doganor të lindur nga veprimet e paligjshme të subjektit, duhet të kryhet detyrimisht njoftimi i subjektit për vendimin administrativ.

Për rastin konkret, Dega Doganore Kapshticë, shikon si të vetmen mundësi, realizimi të njoftimit, bashkëpunimin që mund të vendoset nga Ju, si organ epror organ i cili mund të vendosë komunikim me struktura të nivelit më të lartë, se organi kërkuar Dega Doganore Kapshtice.

Me konkretisht kërkohet që, nëpërmët kanaleve të komunikimit me Ministrinë e Punëve të Jashtme, të kryhet komunikimi për subjektin debitor të sipërcituar, pas përkthimit të aktit nga përkthyes që disponohen/kontraktohen, në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave, për:

1-Dërgimin e vendimit **Nr 5 datë 06/01/2025**, të cilin po ua vendosim në dispozicion bashkëlidhur dhe vendosjen e komunikimit me autoritetet e vëndit shtetas i të cilit është debitori, me qëllim kryerjen e njoftimit, konfirmimin me shkresë, nëse subjekti mori njoftimin, datën e marjes së njoftimit dhe një akt që provon njoftimin.

Duke Ju falenderuar për mirëkuptimin Tuaj, në kushtet kur debitori është shoqeri e huaj shohim si të vetmen mundësi përmbushje të procedurave.

Bashkëlidhur gjenden aktet e sipërcituara

**KRYETARI I DEGES SË DOGANËS KAPSHTICË
DRITAN ÇEKANI**

